



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr. 4/2021 Prot

Vlorë, më 21.12.2021.

VENDIM

Nr.4, datë 09.12.2021

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR  
NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM TË BASHKISË HIMARË, ME  
VENDNDODHJE, BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË**



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënie me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje, për përdorimin e burimit ujor nëntokësor për ujë të pijshëm të Bashkisë Himarë me vendodhje: Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Burimi i Lepushës  
Vendodhja e burimit ujor (KRGJSH)  
X= 487427.26;  
Y= 4451205.09;  
Z=519 m.m.n.d


Sasia e ujit të kërkuar  $Q= 139.10$  l/s  
Prurja mesatare vjetore  $Q_{mes}=104.6$  l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI**

**FLAMUR MAMAJ**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Flamur Mamaj', is written over a horizontal line. The signature is cursive and somewhat stylized.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BAsENIT UJOR VJOSË

Nr. Seriat 000028

LEJE

PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR

Nr. 27 / Prot., datë 21.12.2021

12

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BAsENIT UJOR VJOSË

Nr.4, datë 09/12/2021

Emri i individit/subjektit: **BASHKIA HIMARË**  
I regjistruar si subjekti me këto të dhëna (NID/ NIPT): **K56703211V**  
Baseni Ujor: **VJOSË**  
Qarku: **VLORË**  
Bashkia/ Njësia administrative: **HIMARË**  
Koordinatat: X: 487427.26 Y: 4451205.09 Z: 519 m.m.a.d  
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: **FURNIZIM ME UJË TË PIJSHËM BASHKIA HIMARË**  
Prurja mesatare vjetore: **104.6 l/s**  
Prurja ekologjike: **nuk ka**  
Sasia e ujit që jepet për përdorim: **139.1 l/s**  
Vëllimi i rrjedhës së këtyer (nëse ka): **nuk ka**  
Vendi ku do të shkarkohen rrjedha e këtyer: **nuk ka**  
Vendi i shkarkimit të rrjedrave të përdorura: **Deti Jon (Pjesërisht trajtuar në ITUN Himarë)**  
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e vjitjes): **nuk ka**  
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Sipas kushteve të Lejes**  
Përfundimi i vlefshmërisë: **5 vjet**  
Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve**



KRYETARI

FRAMUR MAMAJ

*Fratur Mamaj*

### Kushtet e posaçme të leles për përdorim burimi ujor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe mjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujor për hidroenergjë, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit.
11. Të lejojë njedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje apo autorizim.
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor në rast të një aksidenti, apo incidenti.
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme.
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur.
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.